



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 05, Datë 06.01.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“GRABOVA HYDROPOWER” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.01.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2584/1 prot., datë 30.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “GRABOVA HYDROPOWER” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GRABOVA HYDROPOWER” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2595 prot., datë 20.12.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Grabova”, me kapacitet të instaluar 14.9 MW, me vendndodhje në pellgun ujë mbledhës të përroit të Grabovës, degë e lumit të Devollit, Qarku Elbasan.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a” dhe “c”; për pikën 2.1 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Rezulton se shoqëria “GRABOVA HYDROPOWER” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), kontratën e Koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim-Operim-Transferim) *Për ndërtimin e Hidrocentralit “GRABOVË I”* nr. 2623 rep., nr. 1238/2 kol., datë 20.11.2017, kontratën shtesë të koncesionit nr. 1020 rep., nr. 304 kol., datë 08.04.2022, si dhe kontratën shtesë të Koncesionit nr. 2524 rep., nr. 945 kol., datë 15.05.2024.
- Ka nënshkruar me “Operatorin e Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a. *“Marrëveshjen për Lidhjen me rrjetin e transmetimit të HEC Grabova 1”*, nr. 4091/4 prot., datë 04.11.2024.;
- Ka depozituar në ERE, Vendimin nr. 9, datë 24.03.2022 *“Për miratimin e lejes “Për përdorim të burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “GRABOVA HYDROPOWER” sh.p.k.”* të Këshillit të Basenit Ujq (KBU) Seman, si dhe Lejen për përdorimin e Burimit Ujq sipërfaqësor nr. 230 prot., datë 31.03.2022, e lëshuar nga KBU Seman. Vlefshmëria e kësaj lejeje është sipas kontratës së koncesionit.
- Ka depozituar Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më datë 20.04.2023, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i HEC Grabova-1”, me fuqi të instaluar 14 900 kW. Kjo VNM është e vlefshme deri më datë 20.04.2025. Duke qenë se nga shoqëria nuk është dhënë ndonjë informacion në lidhje me fillimin e zbatimit të projektit, vlerësohet t’i kërkohet të depozitojë këtë informacion në ERE.
- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe informacioni/dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dëshminë e penaltetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për administratorin e saj.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin që vërteton aftësinë e saj financiare për realizimin e projektit, në përputhje me vlerën e investimit të përcaktuar në kontratën me MIE-n, si dhe parashikimin e planit të biznesit në lidhje me mënyrën e financimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GRABOVA HYDROPOWER” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Grabova 1”, me kapacitet të

instaluar 14.9 MW, me vendndodhje në pellgun ujë mbledhës të përroit të Grabovës, degë e lumit të Devollit, Qarku Elbasan.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “GRABOVA HYDROPOWER” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI